



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË

Nr. 802 Prot.

Lezhë, më 16.06.2025

NJOFTIM
PËR SHPALLJEN E PROCEDURAVE TË KONKURSIT PËR KANDIDATË TË
SHËRBIMIT PSIKOSOCIAL

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, të Urdhrit nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njësive të shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”, i ndryshuar si dhe sipas shkresës së AKAP nr. 1478 prot. date 13.06.2025., DRAP Lezhë shpall konkursin për kandidatët e interesuar për vendet vakante në shërbimin psiko-social pranë institucioneve arsimore.

Shpalljet e vendeve vakante bëhen sipas Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP).

Kandidatët që dëshirojnë të konkurrojnë për t’u pranuar në shërbimin psikosocial dërgojnë nëpërmjet shërbimit postar në adresën e DRAP Lezhë

I. Kriteret për t’u punësuar në shërbimin psiko-social:

A. Kërkesat e përgjithshme që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
4. Të mos jetë dënuar për vepra penale dhe të mos ketë proces penal të hapur në prokurori apo gjykatë;
5. Të mos jetë marrë më parë masë largimi nga punët e mëparshme dhe të mos ketë masa të tjera administrative, apo vërejtje në fuqi.

B. Kërkesat e veçanta që duhen plotësuar për punësim në pozicionet e mësipërme janë:

1. Kandidati duhet të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.
2. Të jetë pajisur me diplomën e ciklit të dytë, në fushën përkatëse.
Psikologu: Diplomë të ciklit të parë dhe të ciklit të dytë, ose ekuivalente në fushën e psikologjisë së edukimit në përputhje me përcaktimet e ligjit 80/2015, (licencë) si dhe leje për ushtrimin individual të profesionit -kopje e njehsuar me origjinalin (licencë), (e detyrueshme);

Punonjësi social duhet të ketë diplomë të ciklit të parë dhe diplomë të ciklit të dytë ose ekuivalente në fushën e punës sociale në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 80/2015 ,(licencë) si dhe hg leje për ushtrimin individual të profesionit -kopje e njehsuar me origjinalin (licencë), (e detyrueshme); ;

3. Njohuri bazë në kompjuter.
4. Zotërimi i gjuhëve të huaja përbën avantazh (dëshmi,certifikata).
5. Aftësi komunikuese dhe punës në grup.

II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

A. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Përshkrimi i edukimit dhe karrierës profesionale –Jetëshkrimin (Curriculum vitae) sipas shtojcës 3 të Urdhërit nr.313, datë 20.10.2020 **(e detyrueshme);**
2. Kërkesë për (pjesëmarrje në konkurrim) për punësim në zyrën arsimore ku dëshirojnë të aplikojnë për pozicionin psikolog / punonjës social **(e detyrueshme);**
3. Raport mjekoligjor i tri muajve të fundit **(i detyrueshëm);**
4. Kopje e njehsuar me origjinalin e Diplomës/diplomave (për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njëhësi nga Ministria e Arsimit **(e detyrueshme);**
5. Listë notash e noterizuar për nivelin bachelor dhe master **(e detyrueshme);**
6. Leje për ushtrimin individual të profesionit -kopje e njehsuar me origjinalin **(licencë), (e detyrueshme); ;**
7. Deklaratë për verifikimin e vërtetësisë së dokumentave të paraqitura nga aplikanti sipas shtojcës 4 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 **(e detyrueshme);**
8. Formular vetëdeklarimi i gjendjes gjyqësore sipas shtojcës 5 të Urdhërit nr.313 datë 20.10.2020 **(e detyrueshme);**
9. Kopje e njehsuar me origjinalin e diplomës së arsimit shtesë dhe listës së notave si dhe certifikatave për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
10. Libreze pune fotokopje e noterizuar nëse ka;
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale e tre muajve të fundit **(e detyrueshme);**
12. Dëshmi penaliteti **(e detyrueshme);**
13. Nëse është i punësuar, vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose vetdeklarim në rastin kur nuk është i punësuar **(detyrueshme).**

B. Të gjithë dokumentat që janë fotokopje duhet të jenë të noterizuara. Nëse në dosjen e aplikimit mungon një nga dokumentat e detyrueshme atëherë kandidati skualifikohet automatikisht.

C. Dokumentacioni i aplikimit dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar në DRAP Lezhë, për të gjithë kandidatët që aplikojnë për punësim në ZVAP-et në varësi të DRAP Lezhë, përkatëse brenda afatit 16.06.2025- 22.06.2025.

Vlerësimi i dokumentacionit të kandidatëve për psikolog /punonjës social të paraqitur në dosje, do të kryhet nga komisioni në periudhën **23.06.2025-27.06.2025**.

1. Rezultatet paraprake të vlerësimit të dokumentacionit do të shpallen në këndin e njoftimeve të institucionit arsimor dhe në faqet zyrtare të ZVAP-ve dhe DRAP Lezhë në datë **27.06.2025**.

2. Kandidatët dërgojnë me e-mail ankesat në adresën zyrtare të DRAP Lezhë (DRAPLezhe@arsimi.gov.al) në afatet **30.06.2025-02.07.2025**.

3. KVD shqyrton ankimmimet e kandidatëve nga data **03.7.2025-04.7.2025**

4. Shpallja e listës përfundimtare e kandidatëve që kalojnë fazën e parë me pikët e dosjes më datë 07.07.2025.

III. Testimi me shkrim për vlerësimin e njohurive të profesionit dhe për njohuritë mbi legjislacionin që lidhet me ushtrimin e profesionit, për kandidatët që kanë kaluar vlerësimin me dosje, do të zhvillohet në datën **09.07.2025, ora dhe vendi do tu njoftohen ne vijim ne faqe zyrtare te DRAP Lezhe.**

IV. DRAP Lezhë shpall listën paraprake të kandidatëve që janë kualifikuar me testimin me shkrim me të paktën 50% të pikëve të testit me shkrim duke filluar nga data 10.07.2025

V. Kandidatët dërgojnë me e-mail ankesat për vlerësimin me shkrim në adresën zyrtare të DRAP Lezhë (DRAPLezhe@arsimi.gov.al) nga data 10.07.2025-11.07.2025.

VI. DRAP Lezhë shpall listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar dhe grafikun e intervistave të strukturuar me kandidatët që janë kualifikuar me testimin me shkrim me të paktën 50% të pikëve të testit me shkrim duke filluar nga data 11.07.2025

VII. Intervista e strukturuar me kandidatët që janë kualifikuar do të zhvillohet me 14.07.2025-16.07.2025

VIII. Në përfundim të intervistës, komisioni ad-hoc shpall listën e kandidatëve për psikologë dhe listën e kandidatëve për punonjës-social në nivel DRAP-i, të renditur sipas pikëve gjithsej, (pikët e dosjes + pikët e testimit + pikët e intervistës). Lista me rezultatet përfundimtare i dorëzohet drejtorit të DRAP-it, i cili e publikon me ID përkatëse në faqen e institucionit brenda datës 17.07.2025

IX. **DRAP Lezhë shpall listën përfundimtare të kandidatëve të kualifikuar në tre fazat e konkurrimit më datë 17.07.2025 .**

Lista e vëndeve vakante për të cilat do të zhvillohet konkurrimi :

NR	DRAP	ZVAP	INSTITUCIONI ARSIMOR QENDER	PROFILI PSIKOLOG/PUNONJES SOCIAL
1	LEZHE	Vau Dejës	SHB "Hasan Meti" Mjedë	Psikolog
2	LEZHE	Vau Dejës	Gjimnazi "Nënë Tereza" Bushat	Psikolog
3	LEZHE	Vau Dejës	9-vjeçare "Rifat Zyeri" Kosmaç	Psikolog
4	LEZHE	Vau Dejës	9-vjeçare "Lush Kola" Barbullush	Psikolog
5	LEZHE	PUKE	PJETER ARBNORI	Punonjës Social
6	LEZHE	PUKE	MIGJENI	Psikolog
7	LEZHE	PUKE	SABAH SINANI	Psikolog
8	LEZHE	PUKE	GJIMNAZI FUSHE-ARREZ	Psikolog
9	LEZHE	PUKE	NIKOLL LLESHI	Psikolog
10	LEZHË	KURBIN	GJIMNAZI "AT'SHTJEFËN GJEÇOVI" LAÇ	Psikolog Provizor
11	LEZHË	KURBIN	9 VJEÇARE MILOT	Psikolog
12	LEZHË	KURBIN	GJIMNAZI MILOT	Psikolog
13	LEZHË	KURBIN	9 VJEÇARE"28 NËNTORI"FUSHË MILOT	Psikolog
14	LEZHË	KURBIN	9 VJEÇARE "NIKË TOMË PRELA"GORRE	Psikolog
15	LEZHË	KURBIN	9 VJEÇARE "DEMOKRACIA"	Psikolog Provizor
16	LEZHE	LEZHE	Shkolla 9-vjeçare "Besëlidhja" Lezhë 703 nxënës	Punonjes Social
17	LEZHE	LEZHE	SHMB Zejmen 338 nxënës	Psikolog provizor
18	Lezhe	Kukës	Shkolla e Bashkuar Shemri 158	Psikolog
19	Lezhe	Kukës	Shkolla "Imer Mata " Zapod 174	Psikolog
20	LEZHË	MALËSI E MADHE	Shkolla e Bashkuar " Kolë Martini " Dedaj nr i nxënësve total 315	Psikolog
21	LEZHË	HAS	SHKOLLA 9-VJEÇAR "SEJDI DIDA" KRUMË	Psikolog
22	LEZHË	HAS	SHKOLLA 9-VJEÇAR "SEJDI DIDA" KRUMË	Punonjes Social
23	LEZHË	SHKODËR	Shkolla 9-vjeare "Seit Can Tagani" Trush	Punonjes Social
24	LEZHË	SHKODËR	Shkolla 9- vjeçare "Salo Halili"	Psikolog
25	LEZHË	SHKODËR	SHB "Nikolle Zagoriani" Velipoje	Psikolog
26	LEZHË	TROPOJË	Shkolla 9-vjeçare "Konferenca e Bujanit"	Psikolog
27	LEZHË	TROPOJË	Shkolla 9-vjeçare "Lekë Çokaj"	Punonjes Social

DREJTOR I DRAP LEZHË



Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti", Godina QKF " Gjergj Lacaj" Kati 2,

Adresa email: DRAPLezhe@arsimi.gov.al